



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.32/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe
Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për
përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore të inicuar sipas ankesës nga _____ me
seli në _____ të cilën e përfaqësojnë _____

dhe

_____ undër Përmbaruesit Privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria
e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ cilën e
përfaqësojnë sipas autorizimit _____ dhe _____ që të dy avoket nga _____

lidhur me veprimet përmbarimore të ndërmarra në rastin, P.nr. 491/2019 të datës 15.07.2019, nga
Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe
Përmbarimin Privat, raportin për iniciimin e procedurës diciplinore e prezantoi _____

„Udhëheqëse e Divizionit për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, në seancën e mbajtur me
datë 22.12.2022, në praninë e përfaqësuesve të palës propozuese, Përmbaruesit Privat me
përfaqësuesit e tij dhe përfaqësueses nga Departamenti për Profesione të Lira nga Ministria e
Drejtësisë, me datë 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti për fillimin e procedurës disiplinore i Ministrisë së Drejtësisë -
Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-
32/2022 i datës 30.11.2022, dhe propozimi për iniciimin e procedurës disiplinore i paraqitur nga
pala ankuese, _____, me seli në _____ më te cilën ka kërkuar që
Përmbaruesit Privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e
Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ si shqiptohet masa
disiplinore shkarkim nga detyra, si i pabazuar.

II. Përmbauesi Privat _____, si organ përmbaues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, të pretenduara nga propozuesi-pala ankuese gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbaimore. P. nr. 491/2019 të datës 15.07.2019, me titull përmbaimore Vendimi i Arbitrazhit të ICC, Rasti , nr. 2099/MHM dhjetor 2016.

A r s y e t i m

Pretendimet e propozuesit të procedurës disiplinore

Me datën 29.11.2022, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, ndaj Përmbauesit Privat, me propozim për iniciimin e procedurës disiplinore, duke pretenduar se përmbauesi privat, me rastin e marrjes së veprimeve përmbaimore të rastit, P. nr. 491/2019 të datës 15.07.2019, me titull përmbaimore Vendimi i Arbitrazhit të ICC, Rasti, nr. 2099/MHM dhjetor 2016, ka bërë shkelje të nenit 367, paragrafi 1, nën paragrafët 1, 2, 4 dhe 10 të Ligjit të Procedurës Përmbaimore (LPP).

Më tutje, propozuesi pretendon se përmbauesi privat ka qenë i njoftuar nga debitori me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbaimore, në rastin , P. nr. 491/2019 të datës 15.07.2019, se është në kundërshtim të hapur me dokumentin përmbaimore – Vendimin e Arbitrazhit, me rastin e përfshirjes në urdhër të shumës prej 1,660,000.00 euro, më tepër se sa borxhi i përcaktuar në dokumentin mbi të cilin e kishte lejuar urdhrin, mirëpo përmbauesi sipas propozuesit ka refuzuar që të shqyrtoi kërkesën e propozuesit-debitorit, lidhur me këtë çështje dhe të përmirësoi urdhrin. Propozuesi poashtu ka theksuar se përmbauesi privat gjatë gjithë procedurës që nga lejimi i përmbaimit, P.nr.491/2019 të datës 15.07.2019, ka bërë tejkalim të kërkesës së kreditorit, se si shkak i veprimeve të kundërligjshme, të ndërmarra nga përmbauesi privat, i cili ka zhvilluar procedura të stërzgjatura përmbaimore dhe i njëjti vazhdon ta bëjë, si pasojë e gabimeve dhe shkeljeve të kryera nga përmbauesi, ka konsumuar kohë në dëm të propozuesit, që ka shërbyer si pretekst që i njëjti ta ngarkoi propozuesin me kamata shtesë, në vlerë prej 2,446,731.00 euro. I ka propozuar Komisionit, që të aprovohet propozimi për iniciimin e procedurës disiplinore dhe përmbauesit privat, t'i shqiptohet masa disiplinore ,shkarkim nga detyra.

Departamenti për Profesionet e Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbaimit Privat, në Ministrinë e Drejtësisë, me datë 30.11.2022, ka hartuar Raportin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbauesit Privat, DPL 32/2022, i cili edhe është prezantuar në seancën dëgjimore të datës 22.12.2022, nga _____ në cilësinë e Udhëheqëses së Divizionit për Noteri dhe Përmbaimit Privat, pranë të cilit raport, e njëjta ka mbetur edhe në seancën e datës së lartcekur.

Pretendimet e Përmbauesit Privat, palë në këtë procedurë

Përmbauesi Privat, përmes përfaqësuesve të tij, si në seancën e mbajtur ashtu edhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar raportin për iniciimin e procedurës disiplinore të Departamentit për Profesionet e Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbaimit Privat, në Ministrinë e Drejtësisë, dhe propozimin për iniciimin e procedurës nga pala ankuese. Më tutje përmbauesi ka deklaruar se asnjë veprim i ndërmarrë me rastin e procedimit të rastit, P.nr.491/2019 i datës 15.07.2019, nuk është në kundërshtim me ligjin, se asnjë shumë e lartësisë së kërkesës, nuk e ka kalkuluar si përmbaues, por të gjitha janë kalkuluar nga eksperti i licencuar gjyqësor, për atë edhe është caktuar seancë nga përmbauesi, për t'i paraqitur vërejtjet eventuale debitori. Përmbauesi privat përmes përfaqësuesve të tij poashtu ka deklaruar se propozimi për iniciimin e procedurës është parashkuar pasi që kanë kaluar mbi tri vite nga lejimi i përmbaimit, duke i propozuar komisionit që të refuzohet si i pabazuar propozimi për iniciimin e procedurës disiplinore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së lartcitur, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe provat shkresore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Baza ligjore për shkelje disiplinore

Neni 367, paragrafi 1, pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbaimore, i përcakton shkeljet përmbaimore për përmbauesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbauesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbauesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbauesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbauesi privat ka shkelur detyrat e parashkuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. Nëse përmbauesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbauesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;

- 1.7. Nëse përmbaruesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbaruesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. Nëse përmbaruesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbarimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Çështjet kontestuese dhe jo kontestuese në këtë rast disiplinor

Në këtë rast midis palëve dhe për komisionin disiplinor, nuk është kontestuese se përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin, me datë 15.07.2019, në bazë të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit, OEN, nr. 20990/MHM të datës 09.12.2016, se kreditori dhe debitori, që në këtë procedurë debitori është propozues i procedurës disiplinore, me datë 24.05.2017, kanë arritur marrëveshje për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit ,nr. 20990/MHM të datës 09.12.2016, ndërsa me datë 16.11.2020, kanë arritur marrëveshje në mes tyre për ekzekutimin e borxhit në procedurë përmbarimore.

Midis palëve rezultuan kontestuese veprimet e ndërmarra të përmbaruesit privat në çështjen përmbarimore, P.nr.491/2019 datë 15.07.2019, për sa i përket mënyrës së kalkulimit të borxhit të mbetur dhe procedimit në përmbarim të kësaj çështje përmbarimore, se a paraqesin shkelje disiplinore të përmbaruesit.

Historiati procedural para se te inicohet procedura disiplinore në këtë rast

Me propozimin për përmbarim P.nr.491/2019 të datës 08.07.2019, të kreditorit në atë procedurë, me seli në _____ është inicuar procedura përmbarimore dhe është lejuar përmbarimi nga përmbaruesi privat lëndor, në bazë të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit OEN, Nr. 20990/MHM i datës 09.12.2016, pasi që i njëjti është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm sipas aktvendimit IV.C.nr.388/2018 i datës 11.02.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

Propozuesi i kësaj procedure, që në procedurë përmbarimore është debitor, ndaj propozimit të lartcekur për lejimin e përmbarimit ka ushtruar prapësim, të cilin prapësim Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me aktvendimin, PPP.nr.1486/2019 të datës 06.07.2020, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin, ashtu që e ka shfuqizuar urdhrin

përmbarrimor, për shumën prej 315,996.85 euro, ndërsa për shumën në lartësi prej 24,684,003.15 euro, e ka refuzuar prapësimin.

Propozuesi i paknaqur me aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e cila me aktvendimin e saj, A.c.nr.3610/2020 me datën 08.10.2020, e ka refuzuar ankesën e propozuesit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e lartcekur PPP.nr.1486/2019 i të datës 06.07.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Prokurori i Shtetit me datë 10.11.2020, ka paraqitur Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1486/2019 i datës 06.07.2020 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, A.c.nr.3610/2020 i datës 08.10.2020, e cila me aktvendimin CML.nr.12/2020 i datës 20.01.2021, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Propozuesi i kësaj procedure, kishte drejtuar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese e Kosovës, e cila me Aktgjykimin K184/21 të datës 24.11.2021, e ka vendos kërkesën të pranueshme dhe ka konstatuar, se ka pasur shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, e ka shpallur të pavlefshëm, Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr. 12/20 itëdatës 20 .01.2021 dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 3610/20 të 08.10.2020.dhe çështjen e ka kthyer për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit, ndërsa propozimin për caktimin e Masës së Përkohshme e ka refuzuar.

Pasi që çështja është kthyer në Gjykatën e Apelit nga Gjykata Kushtetuese, sipas aktgjykimit të lartcekur, Gjykata e Apelit e Kosovës, pas pranimit të Aktgjykimit K184/21 të datës 24.11.2021, me Aktvendimin Ac.nr.265/22 të datës 07.02.2022, e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit – propozuesit, e ka anuluar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1486/19 të datës 06.07.2020, dhe çështjen ia ka kthyer të njëjtës gjykatë në procedim të sërishëm. Gjykata e Apelit kishte dhënë udhëzime që në riprocedurë Gjykata e shkallës së parë, të caktoj seancë me qëllim të dëgjimit të pretendimeve të palëve sa i përket lartësisë së borxhit, poashtu të vlerësoi edhe propozimin për masë të përkohshme, të cilat udhëzime ishin konform udhëzimeve të dhëna edhe nga Gjykata Kushtetuese.

Propozuesi me datë 30.11.2021, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, lidhur me kalkulimin e TVSH-së, pa të drejtë dhe në kundërshtim me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ , nr.06.2014, nga ana e përmbarruesit privat lëndor, për të cilën ankesë ka vendosur Gjykata

Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas aktvendimit KPPP.nr.1757/2022 të datës 20.10.2022, është refuzuar ankesa e debitorit-propozuesit si e pabazuar.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1996/2022 të datës 27.10.2022, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit-propozuesit, për shumën prej 1,660,000.00 euro, me të gjitha kamatat që janë ndërlidhur me këtë shumë të kërkesës, ndërsa pikat tjera të prapësimit janë refuzuar si të pa bazuara dhe më të njëjtin vendim është refuzuar edhe caktimi i masës së përkohshme të sigurisë.

Propozuesi me datë 02.11.2022, ka paraqitur kërkesë për përjashtim të përmbaruesit lëndor, në Gjykatën Komerciale, me arsyetim se përmbaruesi ka indicie të forta se është krejtësisht i njëanshëm dhe kjo shihet me kërcënimin që i ka bërë debitorit-propozuesit, për bllokimin e llogarive bankare. Gjykata e lartcekur me aktvendimin KPPP.nr.1996/2022 të datë 22.11.2022, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e debitorit-propozuesit, për përjashtimin e përmbaruesit privat lëndor.

Propozuesi me datë 24.11.2021, kishte paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë – Divizionin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Profesioneve të Lira, kundër përmbaruesit privat lëndor, lidhur me rastin P.nr.491/2019, me arsyetim se përmbaruesi ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Procedurës Përmbarimore, duke bërë bllokimin e llogarive bankare të propozuesit, pastaj tërheqjen nga llogaria e propozuesit, shumën prej 10,619.62 euro. Propozuesi e kontestoi faturën e përmbaruesit lëndor sepse fatura nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2014 për Tarifatat për Shpërblimin dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbarues Privat, duke vlerësuar se TVSH-ja, duhet të jetë së bashku me tarifën përmbarimore, e jo ti shtohet TVSH tarifës. Divizioni i lartcekur nga Ministria e Drejtësisë, pas inspektimit të punës së përmbaruesit privat, erdhi në përfundim se veprimet e përmbaruesit privat të rasti P.nr.491/2019, nuk përbëjnë cenim të dispozitave të LPP-së e as të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2014, siç pretendon pala ankuese-propozuesi në këtë rast.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit Disiplinor për Përmbarues Privat

Komisioni është lëshuar në vlerësimin e pretendimeve ankimore të inicuesit të procedurës disiplinore, vetëm për sa i për ketë pretendimeve që ndërlidhen me marrjen e veprimeve përmbarimore të përmbaruesit privat, pas marrjes së aktvendimit KPPP.nr.1996/2022 të datës 27.10.2022, të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike. Këtë pretendim propozuesi e thekson në pikën “4”, të propozimit, ku e paraqet propozimin për inicim të procedurës si shkak i veprimeve të kundërligjshme të përmbaruesit.

Pretendimet e propozuesit në pikat 12, 13 dhe 14, të propozimit se nga dhjetori i vitit 2020, përmbaruesi privat, ka qenë në dijeni se urdhri përmbarimor i lejuar P.nr.491/2019 i datës 15.07.2019, është në kundërshtim me vendimin e Arbitrazhit, Komisioni i vlerëson se këto pretendime, janë parashkruar për inicim të procedurës disiplinore, bazuar në nenin 375 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura Disiplinore mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë muajve (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes”*. Nëndërsa, propozimi për inicimin e propocedurës disiplinore është paraqitur nga propozuesi me datë 29.11.2022. Nga kjo rezulton se veprimet përmbarimore të ndërmarra nga përmbaruesi privat që i referohen propozimit në pikat 12, 13 dhe 14, janë të parashkruara, andaj komisioni nuk është lëshuar më tej në vlerësimin e këtyre pretendimeve.

Komisioni disiplinor e vlerësoi pretendimin e propozuesit në pjesën që pretendon se përmbaruesi privat ka qenë i njoftuar nga debitori me rastin e ndërmarrjeve të veprimeve përmbarimore, të rastit P. nr. 491/2019 të datës 15.07.2019, se është në kundërshtim të hapur me dokumentin përmbarimor – Vendimin e Arbitrazhit, me rastin e përfshirjes në urdhër, për shumën prej 1,660,000.00 euro, më tepër se sa borxhi i përcaktuar në dokumentin mbi të cilin e kishte lejuar urdhrin, se përmbaruesi sipas propozuesit ka refuzuar që ta shqyrtoi kërkesën e propozuesit-debitorit, lidhur me këtë çështje dhe të përmirësoj urdhrin, këtë pretendim Komisioni e vlerëson si të pabazë. Kjo nga shkakun se përmbaruesi privat në asnjë rast nuk bënë kalkulim të propozimit për përmbarim e as përpilimin e të njëjtit, por vetëm e lejon apo nuk e lejon përmbarimin në bazë të propozimit të kreditorit me titullin e caktuar për përmbarim. Ndërsa, sa i për ketë kalkulim të shumës, kjo bëhet nga eksperti i licencuar financiar, siç ka ndodhur edhe në këtë rast. Për më tepër parregullsitë e pretenduara nga propozuesi në këtë rast i ka evituar aktvendimi KPPP.nr.1996/2022 i datës 27.10.2022, i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pasi që e ka larguar nga urdhri përmbarimor, shumën 1,660,000.00 euro, me të gjitha kamatat. Konform aktvendimit të lartcekur ka vepruar përmbaruesi privat sipas konkluzionit të datës 28.10.2022 dhe sipas postës elektronike të datës 01.11.2022, e ka njoftuar propozuesin se nga urdhri përmbarimor largohet, shuma prej 1,660,000.00 euro, së bashku me të gjitha kamatat që ndërlidhen me shumën e lartcekur.

Komisioni e vlerësoi edhe pretendimin e propozuesit se përmbaruesi privat gjatë gjithë procedurës nga lejimi i përmbarimit P.nr.491/2019 i datës 15.07.2019, ka bërë tejkallim të kërkesës së kreditorit, dhe erdhi në përfundim se edhe ky pretendim i propozuesit është i pabazuar, ngase përmbaruesi privat është organ përmbarimor që vepron dhe aktivizohet me propozimin e kreditorit, nuk është organ përmbarues që të vlerëson lartësinë e kërkesës së propozuar nga kreditori e as nuk

është përmbartuesi privat ai që duhet të kalkulon lartësinë e kërkesës, pasi kjo bëhet nga eksperti i lëmisë përkatëse, në këtë rast nga eksperti financiar. Komisioni vlerëson se nuk është shkelje disiplinore e përmbartuesit privat pse atij dy herë radhazi ju kanë ndryshuar lejetimet e përmbartimit nga gjykata, siç u konstatuar më lart, sepse kalkulimi siç u vlerësua më lart, nuk është detyrë e përmbartuesit, madje as nuk konsiderohet se është veprim i ndërmarrë përmbartimor nga përmbartuesi, pasi që përmbartuesi e ka mandatin e ekzekutimit të dokumentit së bashku me shumën e përcaktuar në atë dokument të propozuar nga kreditorit. Mirëpo, siç dihet vendimi për lejimin e përmbartimit i nënshtrohet ligjshmërisë së vendimit-urdhrit përmbartimor në gjykata, të cilat edhe e vlerësojnë ligjshmërinë që në këtë rast nuk e kanë anuluar urdhrin si të kundërligjshëm asnjëra nga gjykata sipas aktvendimeve të lartcekura, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, por e kanë ndryshuar të njëjtin vetëm sa i për ketë shumave të lejuara për përmbartim, gjë që ndodh në vazhdimësi në praktikën gjyqësore, që të ndryshohen vendimet e shkallës së parë nga instancat më të larta të gjykatave, si për shumat e gjykuara ashtu edhe për çështje të tjera, prandaj edhe ky pretendim nuk ka të bëjë me shkelje disiplinore nga përmbartuesi privat.

Komisioni nuk e vlerëson se është kërcënim apo shkelje e disiplinore fakti që përmbartuesi ka kërkuar nga propozuesi-debitori, që të bëhet pagesa e borxhit të mbetur sipas email-it, të datës 01.11.2022, sepse ju është lejuar ky veprim përmbartimor sipas aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Komerciale, dhe me të njëjtin aktvendim edhe është refuzuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë, e në anën tjetër siç dihet me ankesë LPP-ja, nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit. Prandaj, edhe ky pretendim është në tërësi i pabazuar, mirëpo nëse edhe më tej propozuesi pretendon se si shkak i kalkulimeve jo të drejta dhe në kundërshtim me raportet financiare të propozueses, janë bërë pagesa apo është tejkaluar shuma që ka rezultuar nga Vendimi i lartcekur i Arbitrazhti, mund të realizon të drejtën e tij eventualisht, propozuesi në ndonjë procedurë tjetër dhe atë ndaj kreditorit, por jo ndaj përmbartuesit privat, i cili nuk është palë në atë procedurë përmbartimore, por është vetëm organ i ekzekutimit.

Sa i për ketë pretendimit të propozuesit se Komisioni, duhet të anuloi seancën e caktuar nga përmbartuesi privat me datë 23.12.2022 dhe pastaj me fjalën përfundimtare ka kërkuar që të anulohet seanca e caktuar me datë 10.01.2023. Komisioni i vlerëson si të pabaza këto kërkesa të propozuesit, ngase nuk është në juridiksionin e këtij komisioni, që të vendos lidhur me menaxhimin e rastit përmbartimor, e as lidhur me seancat e caktuara nga përmbartuesi privat, por ky komision ka për mandat të vlerëson veprimet përmbartimore të përmbartuesit privat se a paraqesin shkelje disiplinore. Duke i vlerësuar këto propozime nga ky këndvështrim as caktimi i seancave nga përmbartuesi privat, nuk paraqesin shkelje disiplinore pasi që siç konstatohet nga

komunikimet elektronike, seancat e caktuara kanë për qëllim definimin e borxhit pas vendimit lartcekur, të marrë nga Gjykata Komeriale.

Komisioni vlerësoi edhe pretendimin e propozuesit për sa i përket zvarritjes së qëllimshme të procedurës nga ana e përmbauesit privat, me qëllim sipas propozuesit që të ngarkohet me kamata e shpenzime debitori-propozuesi, mirëpo edhe ky propozim është i pabazuar sepse me asnjë veprim përmbauesit të ndërmarrë nga përmbauesi privat, nuk është arritur që të vërtetohet në këtë procedurë disiplinore se i njëjti me qëllim e ka zvarritur procedurën. Andaj procedura në këtë rast nuk është zvarritur si shkak i veprimeve të përmbauesit privat, por siç konstatohet nga shkresat e lëndës, procedura është stërzgatur nëpër gjykata, derisa kanë përfunduar procedurat sipas aktvendimeve të lartcekura, pasi që janë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike ndaj vendimeve nga ana e propozuesit.

Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura ligjore dhe nga arsyet e dhëna si më lart, Komisioni Disiplinor, erdhi në përfundim se përmbauesi privat me asnjë nga veprimet e tij përmbauesit, deri në marrjen e këtij vendimi, nuk ka bërë asnjë prej shkeljeve disiplinore, ngase të gjitha parregullsitë e pretenduara për çështjen përmbauesit në fjalë, nga propozuesi i kësaj procedure, janë vendosur dhe evituar me aktvendimet e lartcekura të gjykatave dhe ndryshimet janë bërë vetëm sa i përket shumave të propozuara për përmbauesit, por në asnjë rast nuk është bërë ndonjë shkelje e procedurës përmbauesit nga ana e përmbauesit privat. Poashtu, përmbauesi privat nuk e ka marrë asnjë veprim përmbauesit i cili do të përbënte shkelje disiplinore, pasi që Gjykata e Apelit me aktvendimin, Ac.nr. 265/2022 datës 07.02.2022, e ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1486/2020 të datës 06.07.2020, siç vërtetohet nga komunikimi elektronik i datës 18.03.2022. Andaj, Komisioni Disiplinor vlerëson se Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërin nga shkeljet e lartcituara disiplinore, të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, siç pretendon propozuesi.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 361, paragrafi 2 lidhur me nenin 374 të LPP-së.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.32/2022 datë 30.12.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushë Karaci



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ, bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.